

Evropa dhe institucionet e saj



**Emra të ngjashëm –
a mund ta dalloni
ndryshimin?**

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE



KËSHILLI I EVROPËS

Këshilli i Evropës është një organizatë ndërqeveritare me seli në Strasburg. Në të bëjnë pjesë 46 shtete të Evropës që përfaqësojnë më shumë se 700 milionë qytetarë. Roli i tij është të promovojë demokracinë dhe të mbrojë të drejtat e njeriut dhe shtetin e së drejtës në Evropë.

Komiteti i Ministrave është organi ekzekutiv vendimmarrës i Këshillit të Evropës. Ai përbëhet nga ministrat e jashtëm të shteteve anëtare ose përfaqësuesit e tyre të përhershëm diplomatikë në Strasburg. Ai vendos politikën e Organizatës, miraton buxhetin dhe programin e saj të aktiviteteve dhe monitoron ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Asambleja Parlamentare është organi konsultativ i Këshillit të Evropës. Duke bashkuar përfaqësuesit e zgjedhur nga 46 parlamentet kombëtare, ajo ka iniciuar shumë nga konventat e Organizatës, duke përfshirë Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ajo mbledhet në Strasburg katër herë në vit.

Kongresi i Autoriteteve Vendore dhe Rajonale është përgjegjës për forcimin e demokracisë vendore dhe rajonale në 46 shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. Ai bashkon 612 zyrtarë të zgjedhur që përfaqësojnë më shumë se 150 000 autoritete vendore dhe rajonale.

Komisioneri për të Drejtat e Njeriut është një institucion i pavarur në kuadër të Këshillit të Evropës. Roli i Komisionerit është të promovojë ndërgjegjësimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut në 46 shtetet anëtare të Organizatës.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut gjendet me seli në Strasburg dhe siguron pajtueshmërinë me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në 46 shtetet anëtare. Si individët ashtu edhe shtetet mund t'i dërgojnë çështjet pranë Gjykatës. Vendimet e saj janë të detyrueshme për shtetet në fjalë.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut është një traktat ndërkombëtar i Këshillit të Evropës, i miratuar në vitin 1950. Ajo garanton të drejtat themelore, civile dhe politike jo vetëm për të gjithë shtetasit e 46 shteteve anëtare, por edhe për çdo individ nën juridiksionin e tyre.



BASHKIMI EVROPIAN

Bashkimi Evropian përbëhet nga 27 vende, të cilat ia kanë deleguar pjesërisht sovranitetin e tyre organizatës për t'ï mundësuar asaj të marrë vendime demokratike në nivel evropian për çështje me interes të përbashkët.

Këshilli Evropian përbëhet nga krerët e shteteve ose qeverive të shteteve anëtare dhe nga Presidenti i Komisionit Evropian. Ai përcakton prioritetet kryesore të Bashkimit Evropian.

Këshilli i Bashkimit Evropian është përgjegjës për bashkërendimin e aktiviteteve të përgjithshme të organizatës. Së bashku me Parlamentin Evropian, ai kryen një funksion legjislativ dhe miraton buxhetin e Bashkimit Evropian. Ai përbëhet nga ministra të sektorit përkatës të veprimtarisë.

Parlamenti Evropian përbëhet nga anëtarë të zgjedhur me votim të drejtpërdrejtë universal nga qytetarët e Bashkimit Evropian. Ai gjendet me seli në Strasburg. Takimet e Komitetit dhe seanca të caktuara plenare shtesë mbahen në Bruksel. Ai ndan kompetencat e tij ligjvënës dhe buxhetore me Këshillin e Bashkimit Evropian.

Komiteti Evropian i Rajoneve është asambleja e Bashkimit Evropian e përfaqësuesve rajonalë dhe vendorë. Ai përbëhet nga 329 anëtarë, përfaqësues të zgjedhur të rajoneve dhe qyteteve nga 27 shtetet e BE-së.

Një Komisioner Evropian është një anëtar i Komisionit Evropian, organi ekzekutiv i Bashkimit Evropian. Komisioni, me seli në Bruksel, përbëhet nga 27 komisionerë (një për çdo shtet anëtar). Ai propozon dhe zbaton ligjet evropiane, menaxhon buxhetin, monitoron traktatet dhe siguron menaxhimin e përditshëm të Bashkimit Evropian.

Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian, me seli në Luksemburg, siguron zbatimin e ligjit të Bashkimit Evropian dhe asaj mund t'ï kërkohet nga gjykatat kombëtare të japë një mendim.

Karta e të Drejtave Themelore, një tekst i Bashkimit Evropian për të drejtat e njeriut dhe të drejtat themelore, u miratua në vitin 2000.

A e dinit?

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut u miratua nga Kombet e Bashkuara në vitin 1948 për të përforcuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivel ndërkombëtar. **Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë** është organi gjyqësor i Kombeve të Bashkuara. Ajo gjendet me seli në Hagë.



*All references to Kosovo, wherever in the territory, institutions or population, shall be understood to refer to the territory, institutions or population of Kosovo under the 1999 UN Security Council Resolution 1244, and without prejudice to the status of Kosovo.

- Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës
- Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian



Një flamur i përbashkët

Flamuri u zgjodh në vitin 1955 nga Këshilli i Evropës dhe më pas u miratua nga Bashkimi Evropian në vitin 1985. Kështu ai është bërë një simbol i përbashkët i integritimit evropian, pa qenë specifik për asnjë institucion.

www.coe.int

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 46 shtete anëtare, duke përfshirë të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.

PREMS 065124

SQI

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE